
KËRKESË PËR INFORMIM

PER: PS, PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË
NGA: INSTITUTI SHQIPTAR I SHKENCAVE / OPEN DATA ALBANIA
LËNDA: KËRKESË PËR INFORMIM PËR FINACIME TË PËRFITUARA ZGJEDHJE VENDORE 2015
DATE: 2015-06-09
CC: Z. GENTI GAZHELI – KRYEFINANCIER I PARTISE

I nderuar zoti Gazheli,

Me anë të kësaj shkrese, në emër të Institutit Shqiptar të Shkencave dhe në kuadër të programeve tona për transparencë dhe të dhëna të hapura (open data) paraqesim kërkesën për të na mundësuar me shkrim informacion në lidhje me financimin e fushatës për zgjedhjet vendore, prej datës 22 maj 2015 për subjektin tuaj zgjedhor.

Më konkretisht lutemi të na informoni në lidhje me:

- a) listën e dhuruesve të fondeve jopublike që keni përfituar prej datës 21 maj 2015 dhe që janë mbi shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë ose shërbime apo sende të barasvlershme me të;
- b) listën e çdo shpenzimi që keni kryer eventualisht prej datës 21 maj 2015 me fondet vjetore të përfituara nga buxhetit i shtetit 2015.

Kërkesa jonë bazohet në nenin 9, paragrafi i tretë i Kushtetutës, neni 87/1, neni 89 dhe neni 90 të Kodit Zgjedhor, si dhe të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 2 shkronja “c”, neni 3 dhe neni 11.

Partitë politike kanë një rol të veçantë në shoqërinë demokratike dhe transparenca në kohë e financimeve të tyre, veçanërisht në fushata zgjedhore, është element me rëndësi themelore. Partitë politike kryejnë detyra publike, kanë një rol unik në një shoqëri demokratike dhe mbartin të drejta dhe detyrime si subjekte të së drejtës publike.

Nga ana tjetër kjo krijon njëherësh mundësinë që të zbatohen në praktikë ato që përbëjnë sjellje transparente dhe demokratike në shoqëri dhe do të sjellin një vlerë të shtuar të këtij procesi zgjedhor.

Më lejoni të kujtoj gjithashtu se në mbështetje të nenit 15, paragrafi i parë i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” lutem na përcillini përgjigjen tuaj brenda 10 ditësh pune nga data e marrjes së kësaj kërkesë.


Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Me respekt

Aranita BRAHAJ

Drejtoreshë Ekzekutive
Institutit Shqiptar i Shkencave
Rruga Asim Vokshi,
Pallati 13/25 kat 3
TIRANË
Email: aranita.brahaj@ais.al
Tel: 0682001718





POST RR 188 302 085 AA

Zyra 1

mesel
mesel

LAJMËRIM MARRJE N

vula:



Shqipëria

Ky lajmerim - marrje do te kthehet ne adresën time si më poshtë

Plotësohet nga dërguesi i cili duhet të tregojë drejtimin e tij të plotë për kthimin e këtij lajmerimi

Mod P6

Z. Arumida Brahaj
Instituti Shqiptar i
Shkencave R. Arim
Voksh Pallat 15/25

Kuti 3 TIRANE

277

1. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA PRANUESE E LAJMERIMIT

Objekti..... Nr..... datë..... Lek.....
 Është pranuar në zyrën... *Partia Socialiste - P.S.* në drejtim të zotit
Sheshi Austria Nr 31
TIRANË
Zoti Gent Gaxheli - kryefinancier

2. PËR TU PLOTËSUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT

Objekti i sipërtreguar është..... Dërguar më datën... *12/6/2011*
 Emri mbiemri *(DEKUP) DONOV MIO* Paguar
 Emri mbiemri i shpërndarësit *Vllas*
 SHËNIME TË VACANTA
 Vula datore e Zyrës
 Dorëzuese të objektit

277